



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit
Ministarstvo za Saobraćaj Postu i Telekomunikacije
Ministry of Transport and Communications

Duke u bazuar në autoritetin që buron nga neni 1.3 (ç) i Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 të datës 19 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, me qëllim të rritjes së efikasitetit, cilësisë së punës, besueshmërisë dhe evitimit të konflikteve eventuale të interesave në sektorin e infrastrukturës rrugore.

Ministri, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 2008/3
PËR MBIKËQYRJEN, PRANIMIN TEKNIK DHE KOLAUDIMIN E
PUNËVE TË KRYERA NË INFRASTRUKTURËN RRUGORE

Neni 1

- (1) Mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolaudimin e rrugëve, objekteve rrugore mund ta bëj komisioni i ekspertëve të brendshëm të emëruar nga MTPT, në tekstin e mëtejshëm “Komisioni i Ekspertëve”, ose personi juridik i angazhuar në bazë të LPPK, në tekstin e mëtejshëm “Personi Juridik”.
- (2) Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit në mungesë të kapaciteteve të brendshme do të angazhoj ekspert të jashtëm për mbikëqyrje, drejtat dhe përgjegjësit do të rregullohen me kontratë të veçantë me ligjin e prokurimit publik.

Neni 2

- (1) Personi juridik për mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolaudimin e punëve të kryera në sektorin e infrastrukturës rrugore nënkupton subjektin e zgjedhur i cili i plotëson kushtet e

caktuara dhe kompetencat të cilat do të përcaktohen me rregullat dhe procedurat e tenderit sipas LPPK.

- (2) Personi juridik, në bazë të kontratës me MTPT, do të ushtrojë mbikëqyrjen e punëve, pranimin teknik rrugës, objekteve rrugore dhe kolaudimin e punëve përfundimtare në sektorin e infrastrukturës rrugore në baza profesionale dhe të paanshme.
- (3) Anëtarë të Komisionit të Ekspertëve për mbikëqyrjen e punëve, pranimin teknik të rrugës, objekteve rrugore dhe kolaudimin e punëve të kryera në sektorin e infrastrukturën rrugore duhet të jenë persona me kualifikim dhe njohuri të specializuara në sektorin e infrastrukturës rrugore nga lëmi i ndërtimtarisë, sigurisë në komunikacionin rrugorë e të ngjashëm.
- (4) Përbërja e komisionit caktohet me vendim të Ministrisë.

Neni 3

- (1) Të drejtat, përgjegjësitë, detyrimet për punën e kryer në mes të personit juridik që fiton tenderit për mbikëqyrjen, pranimin teknik, kolaudimin e punëve të kryera dhe MTPT-së rregullohen me kontratë të posaçme.
- (2) Kompensimi material për personin juridik për punën e kryer bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Mbikëqyrja, pranimi teknik dhe kolaudimi i punëve të kryera në sektorin e infrastrukturës rrugore nuk mund të ushtrohen nga anëtarët që mund të i përkasin personit juridik dhe Komisionit të Ekspertëve të emëruar nga MTPT.

Neni 5

Personi juridik apo Komisioni i Ekspertëve për mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolaudimin e punëve të kryera në infrastrukturën rrugore i raporton Departamentit të Infrastrukturës Rrugore dhe Drejtorisë së Rrugëve për çdo projekt veç e veç, një kopje e raportit i dërgohet Ministrit dhe Sekretarit të Përhershëm.

Neni 6

Personi juridik apo Komisioni i Ekspertëve e bënë vlerësimin dhe verifikimin e detajuar të punëve në realizim e sipër nga kontraktuesi për kryerjen e punëve. Për punët pozicionet e përfunduara personi juridik apo Komisioni i Ekspertëve është i obliguar t'i paraqes raport me shkrim, Departamentit të Infrastrukturës Rrugore dhe Drejtorisë së Rrugëve, një kopje e raportit i dërgohet Ministrit dhe Sekretarit të Përhershëm.

Neni 7

Personi juridik apo Komisioni i Ekspertëve e bënë vlerësimin dhe verifikimin e detajuar të punëve të kryera në sektorin e infrastrukturës rrugore, çështjet teknike dhe financiare dhe në bazë të vlerësimit bënë pranimin, plotësimin apo refuzimin e punëve të kryera.

Neni 8

- (1) Kërkesën për mbikëqyrjen e punëve ndërtimore e bënë Drejtoria e Rrugëve përmes Departamentit të Infrastrukturës Rrugore, para fillimit të punëve ndërtimore.
- (2) Asnjë anëtar i personit juridik që bën mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolaudimin e punëve të kryera nuk mund të jetë pjesëmarrës në listën e punëtorëve ose të jetë i lidhur në ndonjë mënyrë me kontraktuesin i cili kryen punët ndërtimore.

Neni 9

- (1) Kërkesën për pranim teknik dhe kolaudimit të rrugës apo objektit rrugor e paraqet Drejtoria e Rrugëve përmes Departamentit të Infrastrukturës Rrugore para se të kryhet ndërtimi, më së voni 15 ditë para përfundimit të rrugës publike, pjesës së rrugës, përkatësisht objekteve rrugore.
- (2) Kryesi i punëve mund të parashtroj kërkesë për pranim të rrugës, gjegjësisht objekteve të rrugës, nëse Departamenti i Infrastrukturës Rrugore dhe Drejtoria e Rrugëve në afatin e paraparë sipas këtij udhëzimi administrativ nuk e parashtrojnë një kërkesë të tillë.

Neni 10

- (1) Personi juridik do të bëjë mbikëqyrjen e punëve ndërtimore duke respektuar planin dinamik për realizimin e punëve dhe përshkrimet e pozicioneve të miratuara nga kontraktuesi dhe MTPT.
- (2) Për çdo ndryshim të planit dinamik si dhe pozicioneve, qoftë në përmbajtje, sasi dhe në cilësi, duhet të njoftohet Drejtoria e Rrugëve ose Departamenti i Infrastrukturës Rrugore.

Neni 11

Personi juridik do të bëjë kontrollimin teknik apo kolaudimin e punëve të kryera; duhet të caktojë planin dhe fillimin e punës së pranimit teknik apo kolaudimit, dhe për këtë e njofton me shkrim Sekretarin e Përhershëm, kryesin e punimeve dhe pjesëmarrësit e tjerë të ndërtimit, ndërsa një kopje i dërgohet Ministrit.

Neni 12

- (1) I njëjti personi juridik nuk mund të bëjë mbikëqyrjen dhe për pranimin teknik ose kolaudimin.

- (2) Gjatë pranimit teknik ose kolaudimit, eksperti nga personit juridik mbikëqyrës duhet të jetë anëtar i komisionit të ekspertëve.

Neni 13

Departamenti i Infrastrukturës Rrugore, Drejtoria e Rrugëve apo Departamenti i Prokurimit dhe kontraktuesi janë të obliguar që personit juridik apo Komisionit të Ekspertëve për mbikëqyrje t'i lënë në dispozicion dokumentacionin tekniko-investues, së bashku me projektin kryesor.

Neni 14

Departamenti i Infrastrukturës Rrugore, Drejtoria e Rrugëve apo Departamenti i Prokurimit dhe kontraktuesi janë të obliguar që Personit juridik apo Komisionit të Ekspertëve për pranim teknik t'i lënë në dispozicion dokumentacionin tekniko-investues me të gjitha ndryshimet që janë bërë gjatë ndërtimit: projektet, ditarët e punës, librat ndërtimorë, certifikatat e atesteve të materialeve të përdorura, dokumentet mbi shqyrtimin e materialeve dhe konstruksioneve, rezultatet për ekzaminimet me ngarkesat provuese të urave, viadukteve dhe objekteve tjera, si dhe dokumente tjera të cilat i përkasin ndërtimit të rrugës.

Neni 15

- (1) Gjatë pranimit teknik të rrugës publike e të objekteve rrugore nga ana personit juridik apo Komisionit të Ekspertëve janë të detyruar të marrin pjesë edhe përfaqësuesit e Departamentit të Infrastrukturës Rrugore, Drejtorisë së Rrugëve, kryesit e punimeve dhe mbikëqyrësit si udhëheqës teknik të punimeve në pjesë të veçanta rrugësh, përkatësisht në objekte të veçanta rrugore.
- (2) Përfaqësuesit e Departamentit të Infrastrukturës Rrugore, Drejtorisë së Rrugëve, mbikëqyrësit dhe kryesit e punimeve janë të detyruar që personit juridik apo Komisionit të Ekspertëve për pranim teknik t'i japin sqarime të nevojshme dhe t'i ofrojnë të dhëna të nevojshme teknike përkitazi me ndërtimin.
- (3) Në pranimin teknik mund të jetë prezent me kërkesën e personit juridik apo Komisionit të Ekspertëve hartuesi i projektit, i cili e ka hartuar dokumentacionin teknik investues të rrugës publike të pjesëve të veçanta rrugore ose të objekteve rrugore.
- (4) Në rast se punëkryesi dhe mbikëqyrësi i projektit nuk i ofrojnë fare apo i ofrojnë të dhëna të pjesërishme apo i vonojnë të dhënat, apo japin të pasakta personi juridik menjëherë do të njoftojë Drejtorinë e Rrugëve, Departamentin e Infrastrukturës Rrugore, Departamentin e Prokurimit dhe Sekretarin e Përhershëm, në këto rastë Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit do të marrë masa sipas kontratës dhe ligjit në fuqi.

Neni 16

- (1) Pranimi teknik bëhet sipas rregullit, pas ndërtimit të kryer të tërë rrugës publike dhe të gjitha objekteve rrugore.
- (2) Pranimi teknik mund të bëhet edhe pas ndërtimit të kryer të pjesëve të caktuara të rrugës publike, nëse ajo pjesë përbën një tërësi dhe mund të dorëzohet për shfrytëzim për komunikacion.
- (3) Pranimi teknik i urave, viadukteve, mbikalimeve, nënkalimeve, tuneleve, mureve mbrojtëse, objekteve për rregullimin e shkëmbinjve nën ujë, drenazhit, ndërtesave dhe objekteve tjera të ndërtimit të lartë në rrugë publike si dhe të objekteve të tjera më të mëdha e më të ndërlikuara ose objekteve që përbëjnë një tërësi teknike të pavarur, bëhet drejtpërdrejt pas ndërtimit të kryer.

Neni 17

- (1) Me pranimin teknik dëshmohet se rruga publike, pjesët e rrugës dhe objektet rrugore janë ndërtuar në pajtueshmëri me dokumentacionin tekniko-investues, standardet e përcaktuara dhe normativat teknike dhe se janë përmbushur të gjitha kushtet teknike dhe janë arritur cilësitë përkatëse teknike për një komunikacion të sigurt dhe të papenguar në rrugë.
- (2) Me pranimin teknik duhet të kontrollohet rregullsia e rrugës publike, pjesëve të rrugës dhe e objekteve rrugore, në pikëpamje ndërtimore-teknike.

Neni 18

Në aspektin teknik të ndërtimit me kontroll teknik të rrugës publike, pjesës së rrugës dhe objekteve në rrugë vërtetohet:

- i. Stabiliteti i konstruksionit të rrugës, urave, viadukteve dhe objekteve tjera në rrugë;
- ii. Aftësia bartëse e rrugës dhe objekteve në rrugë në aspektin e ngarkesës boshtore;
- iii. Aplikimi i elementeve teknike dhe normat mbi ndërtimin e rrugëve;
- iv. Aplikimi i masave teknike për mbrojtjen e rrugës;
- v. Rregullsia teknike e konstruksionit të rrugës dhe objekteve në rrugë;
- vi. Kryerja e ngarkesave provuese dhe shqyrtimet tjera në ura, viadukte mbikalime, mureve mbrojtëse dhe objekteve tjera të njëjta që të vërtetohet reagimi i tyre ndaj ndikimeve që do të provokohen nga automjete që qarkullojnë mbi ato objekte.

Neni 19

Në aspektin teknik të qarkullimit, mbikëqyrjes teknike të rrugës publike, pjesës së rrugës dhe objekteve në rrugë posaçërisht vërtetohet se:

- i. Janë arritur cilësi të rrugëve të cilat mundësojnë qarkullimin me shpejtësi, ngarkesa dhe dendësi të paraparë të komunikacionit;

- ii. Janë ekzekutuar në mënyrë të drejtë udhëkryqet me hekurudha dhe rrugë tjera si dhe trekëndëshi i dukshmërisë;
- iii. Ekziston profili i lirë dhe dukshmëri e nevojshme në rrugë;
- iv. Janë vendosur shenjat e nevojshme përkatëse të komunikacionit, shenjat e rrugëve dhe udhërrëfyesit, ndërsa në vende të rrezikshme janë zbatuar masat e sigurisë;
- v. Ekzistojnë në rrugët ndërkombëtare, autostrada dhe rrugë tjera me dendësi të mëdha të komunikacionit vende të rregulluara për ndalim të makinave jashtë linjave për komunikacion, vendqëndrime të zgjeruara, pushimore dhe hapësira tjera për nevoja të qarkullimit.

Neni 20

- (1) Subjekti Juridik i zgjedhur për pranim teknik ka për detyrë të mbajë procesverbal për punën e komisionit të ekspertëve për pranim teknik. Në procesverbal për punën e komisionit për pranimin teknik duhet të shënohen: të gjithë emrat e anëtarëve të komisionit të zgjeruar për pranim teknik, koha, vendi, rrjedha dhe mënyra e punës së Subjektit Juridik dhe komisionit, lloji i dokumentacioni që i është lënë në dispozicion Subjektit Juridik dhe konstatimet e tij.
- (2) Procesverbalin për punën e komisionit të subjektit Juridik e nënshkruajnë anëtarët e komisionit, përfaqësuesit e investuesit dhe të kryerësve të punimeve dhe personat e tjerë, të cilët kanë qenë të pranishëm në punën e komisionit të subjektit Juridik.

Neni 21

- (1) Pas punës së kryer, personi juridik apo Komisioni i Ekspertëve i pranimin teknik do të përpilojë raportin për kontrollimin e kryer teknik të rrugës publike, pjesëve ose objekteve rrugore dhe do t'i dërgojë raport të shkruar Departamentit të Infrastrukturës Rrugore dhe Drejtorisë së Rrugëve, Sekretarit të Përhershëm dhe kopje Ministrit.
- (2) Raporti i komisionit për pranimin teknik duhet të përmbajë: titullin e organit i cili ka formuar komisionin, numrin e vendimit për formimin e komisionit, emrat e anëtarëve të komisionit, emrin e punëdhënësit dhe të kryesve të punimeve dhe emrat e përfaqësuesve të tyre të cilët kanë marrë pjesë në punën e komisionit, vendin dhe kohën e punës së komisionit, lëndën e pranimin teknik, konstatimin, mendimin dhe propozimet e komisionit të personit juridik si dhe mendimet e ndara të anëtarëve të komisionit nëse ekzistojnë.
- (3) Raportit për pranimin teknik i bashkëngjitet edhe procesverbali i punës së komisionit të personit juridik apo Komisionit të Ekspertëve.

Neni 22

- (1) Personi juridik apo Komisioni i Ekspertëve për pranimin teknik ka për detyrë që në raportin e pranimin teknik të japë konstatimin dhe mendimin për ekzistimin e kushteve për komunikacion të sigurt dhe të papenguar në rrugë publike dhe për mundësitë e shfrytëzimit të papenguar të rrugës, pjesës së rrugës dhe objektit rrugor për komunikacion, për të metat

ndërtimore-teknike në rrugën publike, në pjesën e rrugës dhe në objektin rrugor, për mundësitë e mënjanimin të atyre të metave dhe për kohën e nevojshme për sanimin e tyre.

- (2) Nëse në rrugë publike, në pjesën e rrugës ose në objekt rrugor janë konstatuar të meta, komisioni i personit juridik do të japë mendim nëse mund të dorëzohet rruga publike, pjesa e rrugës, përkatësisht objekti rrugor për komunikacion pas mënjanimin të metave ose duke marrë parasysh llojin dhe natyrën e të metave dhe para mënjanimin të tyre me ndërmarrjen e masave të nevojshme të sigurimit gjatë kryerjes së punimeve të mëvonshme për mënjanimin e të metave.

Neni 23

- (1) Personi juridik për pranimin teknik apo për kolaudim do të propozojë që rruga publike, pjesa e rrugës përkatësisht objekti rrugor do të dorëzohet për komunikacion, nëse konstaton se rruga përmbush kushtet ndërtimore-teknike dhe qarkulluese-teknike për një komunikacion të sigurt e të papenguar.
- (2) Nëse në rrugë publike, në pjesën e rrugës, përkatësisht në objektin rrugor ka të meta që sipas llojit dhe natyrës së tyre nuk ndikojnë në sigurinë e qarkullimit të komunikacionit, komisioni për pranim teknik do të propozojë që rruga publike, pjesa apo objekti të dorëzohet për komunikacion me obligim që të metat të mënjanoen më vonë në afat të caktuar dhe punimet në mënjanimin e të metave të kryhen me masa të nevojshme sigurie. Sipas nevojës, komisioni do të propozojë edhe masa sigurie që duhet zbatuar në interes të sigurisë të komunikacionit gjatë kryerjes së punimeve të mëvonshme në mënjanimin e të metave.
- (3) Nëse gjatë pranimit teknik konstatohen të metat në rrugë publike, në pjesë rruge ose në objekt rrugor që ndikojnë drejtpërdrejt në stabilitetin e rrugës dhe e vejnë në dyshim sigurinë e qarkullimit të komunikacionit, personi juridik për kontrollim teknik do të propozojë që dorëzimi për komunikacion i rrugës përkatësisht objektit rrugor, të bëhet vetëm pasi të mënjanoen të metat.

Neni 24

- (1) Në bazë të propozimit të personit juridik apo Komisionit të Ekspertëve, Departamenti i Infrastrukturës rrugore i rekomandon Sekretarit të Përhershëm që të aprovoj evitimin e të metave të konstatuara gjatë pranimit teknik, në bazë të propozimit të personit juridik, mbi evitimin e të metave të konstatuara gjatë pranimit teknik dhe mbi dorëzimin e rrugës publike, pjesës së rrugës dhe objekteve në rrugë publike për qarkullim.
- (2) Nëse dorëzohet për shfrytëzim rruga publike, pjesa e rrugës përkatësisht objektet e rrugës për të cilat ekzistojnë të meta të cilat sipas llojit dhe natyrës që nuk ndikojnë në siguri dhe qarkullim pa pengesa, Sekretari i Përhershëm do të përcaktojë afatin për eliminimin e të metave, dhe sipas nevojës masat e sigurisë të cilat duhet të ndërmerren për interes të sigurisë së komunikacionit gjatë kryerjes së punëve për eliminimin e të metave.

Neni 25

- (1) Nëse për arsye të parregullsive të konstatuara, rruga publike, pjesa e rrugës apo objekti rrugor nuk është dorëzuar për shfrytëzim, kryesi i punimeve është i detyruar që në afat prej 15 ditësh, kur janë kryer punimet e mëvonshme në mënjanimin e të metave, të kërkojë pranimin teknik plotësues.
- (2) Nëse për shfrytëzim është dorëzuar një rrugë publike, pjesë rruge apo objekt rrugor në të cilin ka të meta, Departamenti i Infrastrukturës Rrugore do të caktojë afat për mënjanimin e të metave, dhe do të bëhet pranimi teknik i mëvonshëm i punimeve të bëra.

Neni 26

- (1) Sekretari i Përhershëm do të autorizoj personin juridik apo Komisionin e Ekspertëve që përsëri të bëjë pranimin teknik vetëm në pikëpamje të punimeve të kryera, mënjanimin e të metave në rrugën publike, në pjesë rruge apo objekt rrugor.
- (2) Pranimin teknik, nga paragrafi 1 i këtij neni e bën sipas rregullit personi juridik për pranimin teknik varësisht nga vëllimi dhe rëndësia e punimeve të kryera, përkatësisht lloji i objekteve në të cilat është bërë mënjanimi i të metave. Sipas nevojës mund të caktohet që pranimi teknik i mëvonshëm të punimeve të kryera në mënjanimin e të metave në rrugën publike në pjesë rruge apo objekt rrugor.

Neni 27

Ky Udhëzim Administrativ shfuqizon Udhëzimin Administrativ 2007/2 Për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ Nr. 2006/4 për mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolaudimin e punëve të kryeura në infrastrukturën rrugore dhe Udhëzimin Administrativ 2006/4 për mbikëqyrjen, pranimin teknik dhe kolaudimin e punëve të kryeura në infrastrukturën rrugore.

Neni 28

Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi me datë **31.03.2008.**

Fatmir Limaj,
Ministër